

VENDIM
Nr. 723, datë 13.12.2023

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË MENAXHIMIT
TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 3, të nenit 3, të ligjit nr. 55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer (në vijim “Agjencia”) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për financat, me seli në Tiranë.

2. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i Agjencisë përbën zë të veçantë në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për financat.

3. Agjencia ka për mision sigurimin e menaxhimit të skemave të veçanta të garancive të huas, si dhe trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyer”.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË AGJENCISË PËR MENAXHIMIN E GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA

Agjencia ka këto përgjegjësi:

- a) organizimin e punës për menaxhimin e skemave të veçanta të garancive shtetërore të huas;
- b) organizimin e punës për kthimin e garancive, huave dhe nënhuave;
- c) organizimin e punës për trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre;
- ç) organizimin e punës për trajtimin e portofolit të investimeve të kryera në banesa nga shoqëria “INSIG” sh.a., para privatizimit të saj.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË

1. Agjencia e shtrihet veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia organizohet në nivel qendror.

2. Me qëllim përmbushjen e misionit, të funksioneve dhe të përgjegjësiave funksionale të saj, Agjencia:

a) mbledh detyrimet e huamarrësve kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat për detyrimet që kanë lindur si rezultat i pagesës së garancive nga ministria përgjegjëse për financat dhe si rezultat i marrëdhënies së huadhënies e nënhuazimit të fondeve;

b) verifikon dhe konfirmon përmbushjen e kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare;

c) administron informacionin dhe dokumentacionin e skemave të veçanta të garancisë;

ç) monitoron shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit, në kuadër të marrëveshjeve të garancisë;

d) kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.

3. Agjencia drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për financat. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët. Ai emërohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit

përgjegjës për financat, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, të nëpunësve dhe të punonjësve administrativë të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave në fuqi të Kodit të Punës.

6. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe sjellja e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri përgjegjës për financat, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë.

7. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e Agjencisë ka shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

8. Vula e Agjencisë ka elementet dhe formën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku